



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.441/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Bujar Muzaqi kryesues, Hajriz Hoti dhe Violeta Husaj Rugova, anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesat e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, të paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me datë 10.02.2025, merr këtë,

V E N D I M

REFUZOHET e pabazuara ankesa Anr.441/2025, e datës 07.02.2025, e parashtruar nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

Me datë 07.02.2025 PZAP ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me të cilën pretendon se kandidati për deputete nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), Dimal Basha, ka postuar në rrjetin social facebook ku shprehimisht thotë: Oferta e 9 Shkurtit e përmbledhur në një foto!, po ashtu ka bashkangjitur postimit edhe një foto të ish kryeministrit Hoti nga radhët e LDK-së, si dhe presidentit serb Aleksander Vuçiqi, ku ka krahasuar subjektin politik LDK me një president serb, i cili në kohën e luftës në Kosovë ka qene edhe Ministër i Informacionit ne Qeverinë e Mirko Marjanovicit, të kasapit te Ballkanit Slllobodan Millosheviq, e cila gjë dihet edhe botërisht (fakt notor).

Sipas parashtruesit të ankesës me këtë veprim kandidati për deputet Dimal Basha, ka nxitur gjuhen e urrejtjes, provokim të skajshëm, shkelje brutale dhe e rëndë të nenit 34. Paragrafi 1, nën paragrafi pika 1.11, të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme të Kosovës i cili shprehimisht thotë “përdorimi i gjuhës në formën e shkruar ose gojore, qe nxit ose provokon, ose që mund të nxis ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë

ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxis urrejtje kundrejt të tjerëve, ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo lloj materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë”

Me këtë parashtruesi i ankesës pretendon se kandidati për deputete nga radhët e LVV-së Dimal Basha, duke bere krahasimin e partisë më të vjetër në trojet mbar shqiptare që është edhe barazim sipas fotos te bashkangjitur me një ish ministër qe ka bere thirrje për vrasjen e shqiptareve në Kosove, me këtë veprim ka bërë shkelje të rëndë që do të mbahet mend në histori të shkeljeve të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, por që e njëjta e tejkalon edhe këtë limit.

Ndonëse PZAP-i përmes vendimeve Anr.137/2025, të datës 24.01.2025, dhe Anr.347/2025 te datës.06.02.2025, ka shpallur përgjegjës subjektin politik LVV per shkak shkeljes së kodit mirësjelljes per subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët dhe i ka shqiptuar dënimi me gjobë, dhe pas plotfuqishmërisë së këtij vendimi, postimi vazhdon të jetë aktiv në profilin e të njëjtit.

Si provë në ankesë ka bashkangjitur foton e postimit.

Në përgjigje në ankesë të paraqitur nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), ka theksuar se LVV i ka njoftuar te gjithë anëtarët e saj me rregullat zgjedhore te përcaktuara sipas LZP-se dhe Rregullat e miratuara nga KQZ, ne lidhje me fushatën zgjedhore po ashtu të njëjtit i kanë udhëzuar ti respektojnë këto rregulla. Po ashtu në përgjigje ne ankesë theksojnë se postimi i Dimal Bashës është hequr nga rrjeti social menjëherë pas pranimit të vendimeve Anr.137/2025 dhe Anr.347/2025 të PZAP. Andaj pas shqyrtimit te gjitha provave dhe argumenteve te parashtruara kërkojmë nga PZAP-i qe ankesën ta refuzoj si te pabazuar.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi dhe vlerësoi pretendimet ankimore gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës, se përkundër vendimeve të PZAP-it postimi i kandidatit të subjektit Politik LVV Dimal Basha, është ende aktive, Paneli thekson se pretendimet e parashtruara me ankesa nga subjekti politik LDK janë të pabazuara, kjo pasi që nuk janë prezantuar prova që tregojnë se ende ekzistojnë postimet për të cilat pala ankuese pretendon, ndërsa nga hetimi që është bërë nga PZAP-i nuk rezulton se të njëjtat postime janë ende aktive në rrjetet sociale për të cilat pretendohet.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: *“vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”*, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë dhe nga provat e ofruara si dëshmi parashtruesi i ankesës si dhe nga hetimi i ndërmarr nga PZAP-ja nuk ka arritur që të vërtetoj se këto veprime paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura të Rregullës Zgjedhore Nr.07/2024, dhe si të tillë të njëjtat e refuzoi si të pabazuar.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës
Anr.441/2025, datë 10.02.2025



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.